



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.140/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gillogjani kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovë (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterëve të kandidatëve të tyre në afërsi të objekteve publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.140/2019 e datës 30.09.2019, e parashtruar nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, ndaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

A r s y e t i m

Me datën 30.09.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe IKS, me të cilën pretendon se me datën 29.09.2019, rreth orës 13:30, në komunën e Fushë Kosovës, saktësisht në afërsi të shkollës fillore “Mihail Grameno”, gjenden dy posterë të kandidatëve të PDK-së, kandidatit për deputet Donjet Bislimi dhe kandidatit për kryeministër Kadri Veseli, të kapur në mbikalimin i cili shërben për kalimin e nxënësve për në shkollë. Sipas paraqitësit të ankesës vendosja e posterëve në afërsi të institucioneve publike është në kundërshtim me rregullën zgjedhore Nr.13/2013, përkatësisht nenin 3.4, dhe se pavarësisht nëse Komuna i ka parapare si vende në të cilën mund të vendosen posterët, ato janë pranë shkollave, brenda perimetrit 100 metër, dhe janë në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuar.

Subjekti politik PDK, në përgjigje thekson se shkelja nuk është në kundërshtim me LZP-në, pasi që hapësira mbi vendkalimin të vendi i njëjtë në Fushë Kosovë është hapësirë e dedikuar për reklama nga komuna e Fushë Kosovës, dhe se këtë hapësirë e ka të kontraktuar “ADS D-line” me të cilën kemi marrëveshje për shfrytëzimin reklamues të fushatës së PDK-së. Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur fotot nga vendi në fjalë, si dhe njoftimin e kompanisë ADS D-linë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e subjektit politik PDK, nuk është bërë shkelja e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi posterët e kandidateve nga subjekti politik PDK, janë vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterëve.

Ndërsa lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës se posterët janë vendosur në afërsi të shkollës Mihail Grameno në Fushë Kosovë, brenda perimetrit 100 metrash, PZAP-i thekson se në këtë periudhe kohore këto veprime nuk janë në kundërshtim me dispozita ligjore. Veprimet e parashtruara në ankesë janë të ndaluara vetëm para fillimit të votimit dhe gjatë ditës së zgjedhjeve në qoftë se ajo shkollë gjatë ditës së zgjedhjeve shërben si Qendër e Votimit ku sipas nenit 85.1 të LZP-së, parashihet që 24 orë para fillimit të votimit të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilido vendvotim ose qendre të votimit në rreze prej 100 metra, duhet të largohen nga anëtarët e KVV-ve, ose Menaxheri i QV-së, dhe se subjektet politike të cilat nuk i kanë larguar ose janë gjetur duke postuar do të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji.

Periudha kohore për të cilën parashihet të aplikohet kjo dispozitë ligjore është 24 orë para votimit dhe gjatë ditës së votimit, kurse ankesa është parashtruar gjatë fushatës zgjedhore, Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës, se këto veprime përbëjnë shkelje të rregullores 13/2013, nga subjekti politik PDK, pasi që posterët në fjalë janë vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e tyre, ashtu siç vërtetohet nga fotografit e ofruara nga pala ankuese që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.140/2019 më datën 02.10.2019

Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada - Glllogjani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.